



**Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly**

LEGJISLATURA V

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 29.

Prishtinë, më 14.12.2015 në orën 21:30

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-2

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Jasmina Zhivković, Agim Çeku, Mufera Sinik, Agim Kikaj, Milka Vuletić, Sasha Milosavljević, Slavko Simić, Çerim Bajrami, Danush Ademi dhe Veton Berisha .

Munguan: Fisnik Ismaili dhe Rustem Berisha.

Pjesëmarrës të tjerë në mbledhje : Ardiana Gashi - përfaqësuese nga OSBE-ja, Zijush Ahmeti- përfaqësues i Sekretariatit të KKK dhe Celal Iliaz, nga Drejtoria për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

.

Stafi mbështetës i Komisionit: Natasha Prica-Tishma, koordinatorë dhe Drita Çarkaxhiu, zyrtarë e lartë ligjore.

Mbledhjen e kryesoi: **Jasmina Zhivković**, kryesuese e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua, ky rend i ditës:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-115, me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregëti dhe Industri;**

1. **Miratimi i rendit të ditës**

Kryesuesja, konstatoi se rendi i ditës u miratua, pa ndryshime.

2. **Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-115, me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregëti dhe Industri;**

Kryesuesja, paraqiti për shqyrtim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-115, dhe kërkoi nga anëtarët e komisioni të deklarohen, nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në rekomandimin, i cili do t'i dërgohet Komisionit FunkSIONal.

Pas shqyrtimit të Projektligjit dhe Raportit të Komisionit FunkSIONal me amendamentet e propozuara, Komisioni me gjashtë (6) vota për dhe dy (2) apstenim, nxori këtë:

Rekomandim

- I. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-115, dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONal, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

Mbledhja përfundoi në orën 22:00

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Jasmina Zhivković